

“OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE” SH.A
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
AKSIONARI I VETËM

Nr. 4/1 Prot

Tiranë, më 20 / 12 /2019

Drejtuar: **“Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” SH.A.**

Lënda: **Dërgohet Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme.**

Bashkëlidhur kësaj shkrese gjeni për zbatim Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Nr. 4, datë 20.12.2019 “Për disa ndryshime në Këshillin e Administrimit të Shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes Sh.A”

Shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” SH.A. të vijojë kryerjen e veprimeve përkatëse në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar.

Adrian ÇELA
Administrator

OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A.



“OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE” SH.A

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË

AKSIONARI I VETËM

VENDIM

Nr. 4 datë 20.12.2019

“Për disa ndryshime në Këshillin e Administrimit të Shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes Sh.A”

Në mbështetje të nenit 135/c të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të Urdhërit Nr. 157, datë 12.02.2018 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Mbi krijimin e tri shoqërive të kontrolluara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.A”, dhe të nenit 15/1 të Statutit të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A., Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A, në mbledhjen e datës 20.12.2019,

VENDOSI:

1. Në përbërje të Këshillit të Administrimit të “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A të bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - lirohet nga detyra e Kryetarit të Këshillit të Administrimit z. Petraq Lika, në vend të të cilit emërohet z. Përparim Nebiaj;
 - riemërohet në detyrën e anëtarit të Këshillit të Administrimit z. Ceno Klosi;
 - emërohet në detyrën e anëtarit të Këshillit të Administrimit z. Dorian Baba.
2. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A. për ndjekjen e procedurave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME
AKSIONARI I VETËM
ADMINISTRATORI I “OSHEE” SH.A
Adrian ÇELA**

